

SHPALLJE E VENDI TË LIRË TË PUNËS**Forca Ajrore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Inter vista	Fillimi	Mbarimi
1	Mekanik/Teknik Helikopteri, mirëmbajtës i pajisjeve testuese/kontrolluese dhe avionik	Reparti Ushtarak nr.3006, Forca Ajrore	Farkë, Tiranë.	E Pacaktuar	Me dosje	-	28.06.2022	12.07.2022

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës:	Mekanik/Teknik Helikopteri, mirëmbajtës i pajisjeve testuese/kontrolluese dhe avionik
2. Kodi i pozicionit:	C2
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr.3006, Farkë, Forca Ajrore
4. Vendi:	Farkë, Tiranë
5. Paga:	VKM Nr.234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Lidhja II, kreu II/1 me Klasën VI, (35000) dhe dëmshmëri dhe vështirësi shëndeti sipas shkallëve të përcaktuara nga Inspektoriati i Shëndetit Publik.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit:	28.06.2022
8. Data e mbylljes së aplikimit:	12.07.2022
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:	<p>a. Grada/Titulli: Civil me arsim të mesëm.</p> <p>b. Arsimi : Mesëm profesional (Mekanike, Elektrike).</p> <p>c. Kualifikimi: Të ketë eksperiencë pune si mekanik elektrik.</p> <p>Të ketë aftësi të mira organizuese, komunikuese dhe prezantuese.</p> <p>d. Trajnimi: Të ketë kryer trajnime të ndryshme në lidhje me specialitetin e kërkuar</p> <p>e. Eksperienca në Punë: mbi 3 vjet.</p> <p>f. Gjuha angleze: 2/1/2/1</p> <p>g. Kërkesa të tjera specifike: Përdorim të programeve bazë të kompjuterit.</p> <p>h. Niveli i certifikatës së sigurisë: e paaplikueshme</p>

11. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore: Kryerja në kohë dhe me cilësi e punimeve në teknikën fluturuese, gjendjen e përdorimit të aparatave matëse-kontrolluese, pajisjeve, instrumenteve dhe veglave të punës; zbatimin e masave të sigurimit teknik e ato kundër zjarrit.

Të jetë në gjendje të kryejë të gjitha llojet e kontrolleve (inspektimeve) të njohë teorikisht dhe praktikisht funksionimin e sistemeve, të përcaktojë të eliminojë shpejt defektet në teknikën fluturuese dhe për defektet e vërejtura ti raportojë Seksionit dhe teknikut të mjetit fluturues.

Të njohë veglat e punës, aparatat matëse-kontrolluese, ti mbajë ato në gjendje të rregullt dhe ti përdorë mirë gjatë punës.

Të plotësojë në kohë dokumentacionin teknik përkatës,

Të punojë në mënyrë të vazhdueshme për ngritjen e tij tekniko- profesionale për të kryer në kohë dhe me cilësi cilësinë kontrollet (inspektimet) dhe punimet e përcaktuara në manualat e shfrytëzimit.

Të jetë në gjendje të kryejë të gjitha llojet e punimeve në teknikën fluturuese, të përdorë aparatat matëse kontrolluese, instrumentet dhe pajisjet që parashikohen gjatë punës,

Të mbajë në gadishmëri të përhershme dhe në gjendje të mirë teknike pajisjet matëse-kontrolluese e veglat e punës, të kontrollojë afatet e përdorimit (kolaudimit dhe kalibrimit) të tyre.

Të eliminojë në kohë dhe me cilësi çdo defekt në teknikën fluturuese, të bëjë përgjithësimin e tyre dhe të propozojë masat parandaluese.

Përgjegjësitë: Përgjigjet për kryerjen në kohë dhe me cilësi të punimeve në teknikën fluturuese për mjetin që ka në ngarkim.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- i. Grada/Titulli: Civil (CII);
- j. Arsimi : I mesëm (Preferuar teknik elektrik)
- k. Kualifikimi: Të ketë eksperiencë pune si specialist/teknik elektrik.
Të ketë aftësi shumë të mira organizuese, komunikuese dhe prezantuese.
- l. Trajnimi: Të jetë i trajnuar në kurse të ndryshme në fushën që mbulon, njohuri në gjuhën angleze dhe njohuri bazë në përdorimin e programeve kompjuterik.
- m. Eksperienca në Punë: mbi 3 vjet.
- n. Gjuha e huaj: 2/1/2/1
- o. Kërkesa të tjera specifike: Përdorim të programeve bazë të kompjuterit dhe njohuri në fushën e veprimit.
- p. Niveli i certifikatës së sigurisë: e paaplikueshme

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Ajrore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.

Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

SHEFI I PERSONELIT

NËNKOLONEL VLADIMIR JAUPI